

VENDIM
Nr. 460, datë 30.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 337, DATË 9.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN, NË PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE ELBASAN, TË NJË PJESE TË PASURISË 5/38, ME EMËRTIMIN “ISH-ZYRAT E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8521, DHE TË PASURISË 15/43, ME EMËRTIMIN “ISH-DREJTORIA ARSIMORE ELBASAN”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 8524, DHE PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 416, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4, e vendimit nr. 337, datë 9.6.2021, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
2. Ngarkohen Bashkia Elbasan dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe